



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Shijak , më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“ SISTEMI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË TË ARDHURAVE VENDORE
NË BASHKINË SHIJAK”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbimet për sistemet IT

VLERA E FONDIT LIMIT: **2.000.000 leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Vore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. . **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2021,2022,2023), nga data e zhvillimit të procedurës të jetë sa 40 % e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Pasqyrat Financiare të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të certifikuara nga organet tatimore dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlere eshte brenda limiteve te percaktuara ne LPP VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nuk sjelle kufizim te konkurrences duke gene se marzhi prej 39% e fondi limit eshte nje vlere relativisht e ulet per nje OE i cili eshte i qendrueshem ne treg dhe krijon bindjen per AK per nje realizim me sukses te kontrates.

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme të realizuara me sukses, të një ose disa kontratave të mëparshme, gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën prej jo më pak se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një produkt të certifikuar sipas : ISO/IEC 25001:2014

ISO/IEC 25001:2014 është një standard ndërkombëtar i njohur si "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Softëare-it". ISO/IEC 25001:2014 ka për qëllim të përcaktojë specifikat e përmbledhura për cilësinë e produkteve dhe sistemeve të softëare-it. Përmes këtij standardi, synohet të ndihmohet në hartimin dhe përdorimin e kriterëve të cilësisë, si dhe në vlerësimin dhe testimin e cilësisë së softëare-it.

2.3.2.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një produkt të certifikuar sipas : ISO/IEC 27018:2019:

ISO/IEC 27018:2019 është një standard ndërkombëtar i cili përfshin udhëzimet për menaxhimin e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale në "cloud computing". Ky standard ka të bëjë me përpunimin e informacionit personal nga OE të "cloud computing" dhe siguron një përcaktim të qartë të përgjegjësive dhe detyrave të tyre në këtë kontekst. Ky standard ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë dhe privatësisë për personat e cilet janë përfshirë në përpunimin e të dhënave personale në mjediset e "cloud computing".

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat

ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht

- ISO 25001:2014 - Inxhinieri Sistemeshe dhe Softëare-sh

ISO/IEC 25001:2014 ofron kërkesa dhe rekomandime për një organizatë përgjegjëse për zbatimin dhe menaxhimin e sistemeve dhe kërkesave për cilësinë e produkteve softuerike, specifikimet dhe aktivitetet e vlerësimit përmes ofrimit të teknologjisë, mjeteve, përvojave dhe aftësive menaxheriale.

- ISO 27018:2019 - Teknologji Informacioni

ISO 27018:2019 është një standard që ofron udhëzime për ofruesit e shërbimeve cloud për mbrojtjen e të dhënave personale. Ai fokusohet në trajtimin e sigurt të të dhënave personale, sigurimin e transparencës, mbajtjen e llogaridhënies, zbatimin e sigurisë së të dhënave dhe përcaktimin e procedurave për njoftimet për shkeljen e të dhënave. Pajtueshmëria me këtë standard i ndihmon ofruesit të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj privatësisë dhe sigurisë së të dhënave.

- ISO 22301:2019 - Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit.

ISO 22301:2019 është një standard që specifikon kërkesat për të planifikuar, vendosur, zbatuar, operuar, monitoruar, rishikuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht një sistem të dokumentuar të menaxhimit për të mbrojtur kundër, reduktuar gjasat e shfaqjes, përgatitjen, reagimin dhe rikuperimin nga incidentet përçarëse kur ato linden. Objektivi është të sigurohet elasticiteti dhe vazhdimësia nga OE gjatë ngjarjeve ose fatkeqësive të papritura, duke minimizuar ndikimin dhe kohën e ndërprerjes.

- ISO 14001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

ISO 14001:2015, siguron një kornizë për OE për të mbrojtur mjedisin, për t'iu përgjigjur kushteve mjedisore në ndryshim në ekuilibër me nevojat socio-ekonomike dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm në performancën mjedisore. Ky standard ndihmon OE të arrijë objektivat mjedisore nëpërmjet një qasjeje sistematike, duke rritur performancën mjedisore, duke përmbushur detyrimet e pajtueshmërisë dhe duke arritur objektivat mjedisore.

- ISO 27001:2013 - Siguria e Informacionit

ISO/IEC 27001:2013 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda kontekstit të organizatës.

- ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

ISO 45001:2018 është një standard ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Ky standard është projektuar për të ndihmuar organizatat në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës duke përcaktuar dhe menaxhuar risket e mundshme. Përmes implementimit të këtij standardi, OE duhet të krijojë një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në vendin e punës, duke ulur rreziqet dhe duke siguruar pjesëmarrjen aktive të punonjësve në proceset e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

- ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

ISO 9001:2015, siguron që operatori ekonomik ofron në mënyrë të vazhdueshme produkte dhe shërbime me cilësi të lartë, efikas, redukton gabimet dhe ruan një standard të lartë të ofrimit të shërbimit

- ISO 20000-1:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

ISO/IEC 20000-1:2018, fokusohet në Sistemet e Menaxhimit të Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSMS), duke ndihmuar OE të menaxhojë dhe ofrojë

në mënyrë efektive shërbimet e IT. Standardi përshkruan një sërë procesesh që OE duhet të krijojë për të siguruar dizajnimin, tranzicionin, ofrimin dhe përmirësimin efikas të shërbimeve të TI-së. Qëllimi është të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të përmirësojë kënaqësinë e klientit dhe të sigurojë një ofrim të besueshëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të IT, duke i përafuar ato me kërkesat e biznesit dhe të klientit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

2.3.5 OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë .Net I certifikuar per Quality Sistema Compita Netëork+ (e provuar meCV, kontratë pune, diplomë, dhe I përfshirë në listë pagesën e periudhës së fundit).

Argumentimi : Një zhvillues me këtë profil ka aftësinë të kuptojë dhe zbaton më mirë kërkesat e projektit, të identifikojë dhe zgjidhë problemet teknike me efikasitet dhe të kontribuojnë arkitekturën dhe dizajnin e sistemit. Kjo jo vetëm që rrit cilësinë dhe performancën e produktit përfundimtar, por gjithashtu siguron një proces zhvillimi më të qëndrueshëm dhe të optimizuar.

2.3.6 OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë .Net I certifikuar (e provuar me CV, kontratë pune, diplomë, dhe I përfshirë në listë pagesën e periudhës së fundit)

Argumentimi : Kërkesa për një zhvillues senior në .Net me certifikim nëQuality Sistema Compita Netëork+ është nevojshme për të siguruar ekspertizën teknike dhe efikasitetin e projektit, duke ndihmuar në ngritjen e standardeve të përgjithshme të cilësisë dhe standartit të projektit.

Certifikimi në CompTIA Network+ i ndihmon zhvilluesit të kuptojnë bazat e rrjetit, të përmirësojnë aftësitë e zgjidhjes së problemeve, të përmirësojnë bashkëpunimin me ekipet e IT, të zgjerojnë mundësitë e karrierës dhe të mbështesin zhvillimin e sigurt të aplikacioneve. Është krijuar për të ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të teknologjive të rrjetit, të dobishme për zhvilluesit e përfshirë në projekte të lidhura me rrjetin ose që synojnë të zgjerojnë ekspertizën e tyre teknike.

2.3.7 OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë React i certifikuar me ISO 27001 (e provuar me CV, kontratë pune, diplomë,I përfshirë në listë pagesën e periudhës së fundit)

Argumentimi: Zhvilluesi me përvojë në React do të jetë i aftë të ndërtojë ndërfaqe

përdoruesi që janë jo vetëm responsive dhe intuitive, por edhe të optimizuara për performancë. Certifikimi ISO 27001 garanton që ky zhvillues është i njohur me standardet më të larta të sigurisë së informacionit, do të ndihmojë në garantimin e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të sistemeve dhe të dhënave, duke ofruar vlera të shtuara për të projektit.

Punonjësit e sipërpermendur të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë
- d) CV (jetëshkrim)

2.3.8 Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Database Administrator në Oracle të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe IT Audit (për këtë OE duhet të dëshmojë certifikatat përkatëse, dhe kontraten)

Argumentimi: Ky specialist nevojitet që të ketë një ekspertizë të thellë në administrimin e databazës Oracle, të jetë i aftë në menaxhimin dhe auditimin e sigurisë, të mund të hartojë raporte auditimi dhe të zbatoj masat korrigjuese. Specialisti duhet të ketë njohuri të thella në optimizimin e performancës së bazës së të dhënave, duke mundësuar një shfrytëzim të efektshëm të burimeve dhe një përgjigje të shpejtë ndaj kërkesave.

2.3.9 Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën përkatëse dhe kontratë)

Argumentimi : Certifikimi CISA vërteton se audituesi ka njohuri të thella dhe të gjerë në vlerësimin e rrezikut dhe kontrollit të teknologjisë së informacionit, duke siguruar që praktikat e auditimit janë në linjë me standardet ndërkombëtare. Ky ekspert është i pajisur për të identifikuar dobësitë në infrastrukturën e IT, të sugjerojë përmirësime dhe të monitorojë zbatimin e masave korrektive, duke ndihmuar OE të mbrojë pasuritë e saj digjitale, të përmbushë rregullativat dhe të përmirësojë proceset e biznesit për të arritur objektivat strategjike.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 3 punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listat pagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjisllacionit përkatës; dhe/ose d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë stafin e kualifikuar profesionalisht për kryerjen e këtij shërbimi.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e sipercituar emrin dhe profilin e punës.

NJESIA E PROKURIMIT